



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
eëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300288/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313, "Jordan Misja", Tiranë.*

Drejtuar: Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Kejdis ÇELA
Drejtor i IEVP-së 313 "Jordan Misja", Tiranë

TIRANË

I nderuar z. Abrija,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313 "Jordan Misja" në Tiranë.

Inspektimi u krye në datë 23.03.2023 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ligjore vendase dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. Aspekt tjetër i vizitës inspektuese ishte edhe vlerësimi i kushteve infrastrukturore të institucionit për jetesë

normale të të paraburgosurve, natyra, llojshmëria dhe cilësia e aktiviteteve që zhvillohen në klasa dhe në vendet e ajrimit në funksion të rehabilitimit të tyre, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka të drejtën dhe detyrimin ligjor, t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të parashtrijë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Vizita inspektuese në IEVP 313 “Jordan Misja” në Tiranë, u zhvillua në kuadër të inspektimeve periodike që zhvillon MKPT në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Bazuar në metodologjinë e inspektimit, grupi i inspektimit u takua me zv/drejtorin e IEVP-së 313 z. Petrit Myslymi dhe shefin e policisë z. Alban Jahollari, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Drejtuesit e institucionit, informuan në lidhje me respektimin e të drejtave ligjore dhe trajtimin e të paraburgosurve në këtë institucion, ofrimin e shërbimeve, plotësimin e kushteve të jetesës, si dhe llojet e aktiviteteve që zhvillohen me të paraburgosurit.

Sipas informacionit, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "*Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, IEVP 313 “Jordan Misja” klasifikohet institucion paraburgimi*, me një seksion paraburgimi, një seksion të veçantë për personat që konsiderohen “bashkëpunorë të drejtësisë”, sipas kritereve të ligjit nr.10461, datë 12.09.2011 "*Për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë*", i ndryshuar dhe një seksion (godina C), për zbatimin e regjimit të posaçëm (*i ashtuquajtur i 41-bis*), sipas kritereve të nenit 17 të ligjit 81/2020, "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

Kapaciteti fizik i IEVP 313 “Jordan Misja”, është për akomodimin e 480 personave, nisur nga numri i dhomave për banim në godinat “A”, “B” dhe “C” në regjimin e brendshëm, dhomat në ambientet e tranzitit, veçimit dhe të observimit, dhomat në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë (41 biss), si dhe numri i shtretërve për fjetje për të paraburgosurit.

Në ditën e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, **ndodheshin 441 persona të paraburgosur**. Situata e popullimit për periudhën e fundit 6 – mujore, rezultoi të ishte si më poshtë:

- Tetor 2022 449 të paraburgosur
- Nëntor 2022 453 të paraburgosur
- Dhjetor 2022 424 të paraburgosur
- Janar 2023 432 të paraburgosur
- Shkurt 2023 407 të paraburgosur

¹ Shkresë nr.K4/I48-2 prot., datë 14.11.2022 drejtuar DPB dhe drejtorit të IEVP 313.

Pavarësisht statistikave të popullimit, theksojmë se ambientet e banimit në këtë institucion, kryesisht në godinën “A”, nuk janë në kushte dinjitoze për jetesë normale, për shkak të mungesës të hapsirave dhe kubaturave për ndërtimin e dhomave të banimit. Në këto kushte, lind nevoja e uljes së numrit të shtretërve dhe rrjedhimisht zvogëlimin e kapacitetit të kësaj godine, pasi në atë gjendje që janë dhomat e banimit, situata në godinën A është në kushtet e mbipopullimit.

Nga informacioni, institucioni nuk kishte urdhër për përcaktimin e kapacitetit akomodues, pasi IEVP 313 ka në përbërje sektorin e paraburgimit, por edhe sektorin e Regjimit të Posaçëm (41 bis) dhe sektorin e dëshmitarëve të drejtësisë. Në këto kushte, ndonëse institucioni nuk ka mbipopullim në lidhje me numrin e përgjithshëm të të burgosurve, ai ekziston në disa sektorë. Për më shumë lexoni në pjesën e kushteve materiale më poshtë.

Ambientet për sektorin shëndetësor dhe sektorët e shërbimeve, kuzhina, lavanderia, dhomat e takimit me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, postet e takimit me familjarët, sektori i tranzitit, observimit dhe i veçimit, ndodhen në katin e parë në godinën A dhe godinën B në regjimin e brendshëm.

Struktura organike e IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, është e miratuar me urdhër nr.43, datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj*”. Organika e institucionit përbëhet nga **347 punonjës**, nga të cilët 53 punonjës civil dhe 294 punonjës të sektorit të policisë.

Në momentin e inspektimit, institucioni kishte gjithsej **32 vende vakante**, nga të cilat 2 vende në stafin civil (1 elektromekanik dhe 1 mirëmbajtës) dhe 30 vende vakante në stafin policor. Pavarësisht mungesave në organikë, drejtuesit e institucionit informuan se ato nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në sigurinë dhe ofrimin e shërbimeve për të paraburgosurit.

Sipas informacionit, intervistat me të paraburgosurit dhe nga inspektimi i kryer në ambientet e regjimit të brendshëm, situata e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi si më poshtë vijon:

Ishin plotësuar rekomandimet:

- ✓ për miratimin e urdhërit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë, “*Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit*”, me qëllim përmirësimin e larmisë së menisë të ushqimit të të burgosurve.
- ✓ për lidhjen e kontratave të punës midis institucionit dhe të paraburgosurve të punësuar, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2022.
- ✓ për kompletimin e bibliotekës të institucionit dhe dhomave të këshillimit, me libra të rinj, me qëllim rritjen e interesit të të paraburgosurve për leximin e librave.
- ✓ për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e burimeve njerëzore dhe sektorin shëndetësor, sipas strukturës organike të institucionit.

- ✓ për vendosjen e një regjistri për evidentimin e korrespondencave të të paraburgosurve me institucionet e tjera jashtë I EVP, duke përshtetur kohën e nisjes dhe atë të marrjes në dijeni nga ankuesi, në lidhje me përgjigjen e institucionit të cilit ai i është drejtuar.
- ✓ ishin përmirësuar disa nga kushtet për të burgosurit në sektorin e regjimit të posaçëm (41 biss), pasi ishin instaluar TV (me orar dhe programe të reduktuara) në çdo dhomë dhe ishte përmirësuar cilësia e ushqimit.

Ndërkohë, nuk ishin plotësuar rekomandimet:

- ✓ për rregullimin, mirëmbajtjen, eliminimin e lagështirës, sigurimin e ujit të rrjedhshëm, dizifektimit dhe pastërtinë higjieno-sanitare në ambientet e tranzitit, observimit dhe veçimit.
- ✓ për miratimin e rregullores së brendshme të I EVP-së 313 “Jordan Misja”, Tiranë, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
- ✓ për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për ngrohje të dhomave të të paraburgosurve në godinën A të këtij institucioni, sipas kushteve klimaterike.
- ✓ për larmshmërinë e aktiviteteve psiko-sociale, trajtimit dhe këshillimit individual me të paraburgosurit, si dhe lejimin e aktiviteteve fetare me të paraburgosurit që ndodhen në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë (41 biss).
- ✓ për shtimin e aktiviteteve të përbashkëta me karakter kulturor, sportiv dhe edukativ me të paraburgosurit, me qëllim rritjen e aftësive të formimit dhe të kapaciteteve rehabilituese të tyre.
- ✓ për miratimin e urdhërit nga DPB për përcaktimin e kapaciteteve fizike të I EVP-ve, sipas normave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Vizita inspektuese në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe grupit të MKPT-së ju ofruan të gjitha lehtësitat për kryerjen e inspektimit, kqyrjen e ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe zhvillimin e intervistave me të paraburgosurit pa mbikqyrjen e stafit të sigurisë së institucionit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Trajtimi i të paraburgosurve

Vizita inspektuese e MKPT-së në I EVP 313 “Jordan Misja, kishte në fokus kryesor mbledhjen e informacionit me qëllim identifikimin e rasteve potenciale të keqtrajtimit të personit, përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, si dhe përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative apo dhe të presionit psikologjik ndaj të paraburgosurve.

Gjatë inspektimit, grupi i MKPT-së u njoh me dokumentacionin dhe administroi kopje të praktikave të punës së komisioneve të ngritura me urdhër të drejtorit të I EVP-së, që kanë të bëjnë me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të paraburgosurve, pranimin dhe trajtimin e të burgosurve të sapoardhur në institucion, si dhe rregullat dhe procedurat e ndjekura nga komisioni i disiplinës për dhënien e masave disiplinore të lehta apo të rënda, në varësi të shkeljeve disiplinore të kryera nga të paraburgosurit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Nga informacioni dhe nga intervistat konfidenciale me të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për ushtrim të dhunës dhe keqtrajtimit të tyre, si dhe tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Në intervistat e zhvilluara, të paraburgosurit në godinën A ngritën me shqetësim mungesën e kushteve të përshtatëshme për jetesë, infrastrukturën e dobët të shërbimeve, si dhe për lagështinë e ambienteve, për shkak se kjo godinë është e vjetër dhe e amortizuar. Mungesa e shërbimeve dhe kushteve të jetesës, përbën trajtim jo dinjitoz dhe njerëzor të të paraburgosurve që qëndrojnë në mjediset e kësaj godine.

Nga inspektimi në godinën A, grupi i MKPT-së evidentoi problematika të përsëritura në infrastrukturën e saj, që konsistojnë në:

- përmasat e dhomave të banimit, nuk plotësojnë kriteret e sipërfaqes dhe të hapsirës së lejueshme, që duhet të sigurohet për çdo të burgosur²;
- prezencën e lagështirës në ambientet e dhomave të banimit, si dhe në ambientet e përbashkëta të tualeteve dhe të dusheve;
- problemet me sistemin e brendshëm elektrik që përbënte rrezik për sigurinë e jetës së të paraburgosurve, si dhe mungesën e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të banimit;
- mungesën e ujit të ngrohtë në dushe për larjen e trupit, pasi sasia e disponueshme nuk përballonte nevojat e të paraburgosurve;
- kushtet e papërshtatshme në ambientet e përbashkëta të klasave dhe në ambientet e ajrimit në godinën “A”, të cilat ishin shumë të kufizuara për zhvillimin e aktiviteteve, etj.

Një shqetësim i ngritur në mënyrë të përsëritur nga institucioni i Avokatit të Popullit, që lidhet me infrastrukturën në godinën A, ka të bëjë me gjendjen e përkeqësuar të kushteve të dhomave që ndodhen në sektorin e tranzitit dhe të observimit të këtij institucioni. Kushtet e jetesës në këto ambiente, vijojnë të jenë degraduese dhe jo dinjitoze, pasi materialet e fjetjes ishin të vjetëruara, ambienti i dhomave ishte me lagështirë, si dhe kushtet higjeno-sanitare të përkeqësuar. Numri i personave në sektorin e tranzitit ishte i lartë dhe lëvizte çdo ditë, për shkak të dinamikave të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë. Veç kushteve të vështira, të burgosurit që akomodohen në dhomat e tranzitit, ngritën me shqetësim edhe ditët e gjata të qëndrimit (deri në 7 ditë) në këtë ambient, kjo në varësi të planifikimeve të lëvizjeve që miratonte DPB-ja për kthimin e tyre në vendet e vuajtjes së dënimit.

Të paraburgosurit në intervistat e tyre, ngritën ankesa në lidhje me zëvendësimin e dyshekëve të fjetjes të dëmtuar me dyshekë të rinj. Grupi i inspektimit, kërkoi informacion nga sektori i logjistikës të institucionit për këtë shqetësim, të cilët informuan se,

² Neni 33 i ligjit nr.81/2020: “Në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar ***kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m²*** për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

institucioni ka gjendje në magazinë dyshekë të rinj, por materialet e fjetjes nuk mund të ndërrohen shpesh sipas kërkesave të të paraburgosurve, pasi ato kanë një afat përdorimi deri në 6-vjet.

Mungesa e ujit të rrjedhshëm në mjediset e banimit, ishte një problematikë tjetër që u ngrit si ankesë nga të paraburgosurit në godinën A dhe godinën B. Sipas intervistave me të paraburgosurit, furnizimi me ujë i ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej me orar të reduktuar 3 herë nga 1.5 orë në ditë, kohë e cila është e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e higjenes personale dhe mbajtjen pastër të ambienteve të përbashkëta.

Të paraburgosurit, besimtarë të fesë myslymane ngritën si problematikë, sigurimin e kushteve dhe trajtimin ushqimor, për respektimin e riteve gjatë muajit të Ramazanit. Ata deklarorin se, shqetësimin e kishin ngritur edhe pranë drejtuesve të institucionit, por ende nuk kishin marrë përgjigje. Në vlerësimin e institucionit tonë, kjo situatë është e nevojshme të rregullohet menjëherë nëpërmjet një urdhëri të brendshëm të miratuar nga drejtori i IEVP-së, sikurse përcaktohet në nenin 36 të ligjit 81/2020, ku thuhet shprehimisht se: *“Të burgosurit i sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën e punës, kushtet klimaterike, besimin fetar dhe nevojat e veçanta të tij”*.

Masat mbrojtëse

Grupi i inspektimit të MKPT-së, për vlerësimin e përgjithshëm të institucionit, në kuadër të respektimit dhe garantimit të të drejtave të të paraburgosurve, verifikoi dhe administroi kopje të dokumentacionit me praktikën e punës për secilin sektor.

Në zbatim të kërkesave të ligjit 81/2020 dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, u verifikua dokumentacioni dhe procedura që ndiqet nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore, për funksionimin e sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave në institucion.

Nga kqyrja e dokumentacionit u evidentua se, për çdo kërkesë apo ankesë, të paraburgosurit plotësonin një formular, i cili i dorëzohej punonjësit të sektorit të çështjeve shoqërore dhe brenda ditës kërkesë/ankesa protokollohej në sekretarinë e institucionit në një regjistër të veçantë të miratuar për këtë qëllim. Ky regjistër administrohej dhe plotësohej sipas rubrikave nga sekretaria e institucionit, si dhe ishte i vulosur me vulën e institucionit³.

Në varësi të objektit të kërkesë/ankesës, drejtori i institucionit urdhëronte me shkrim sektorët përkatës t'i kthenin përgjigje ankuesit, orientonte ankuesin të drejtohej me shkresë zyrtare organit epror në DPB, si dhe organizonte takime me ankuesit në ambientet e regjimit të brendshëm, brenda një afatit 3(tre) ditor. Gjatë vitit 2022 ishin evidentuar në regjistër gjithsej 774 kërkesë/ankesa nga të paraburgosurit, të cilat sipas shënimeve në regjistër ishin zgjidhur nga institucion ose ishin adresuar organit epror në DPB për të zgjidhur ato.

³ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Nga shënimet në regjistër, objektit i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, komunikim me skype, vizita në spital, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer, etj.

Në lidhje me korrespondencat e të paraburgosurve me institucionet e tjera jashtë sistemit penitenciar, pasi depozitoheshin në një kuti postare që ndodhej në çdo sektorë në regjimin e brendshëm, një nga punonjësit e institucionit i ngarkuar me detyrë nga drejtuesit e institucionit, hapte kutitë dhe i dërgonte ato brenda ditës në postë, për tu nisur sipas adresave. Kjo praktikë evidentohet në një regjistër të veçantë, që ndodhej në sekretarinë e institucionit.

Grupi i monitorimit verifikoi gjithë dokumentacionin ku evidentohet procedura e zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit të Pritjes në institucion, për hyrjet e reja dhe pritjen e të paraburgosurve. Mbledhjet dhe përbërja e komisionit të pritjes, ishte e organizuar sipas urdhërit të drejtorit të IEVP-së për këtë qëllim. Praktika e punës të komisionit, protokollohej dhe mbahej në sekretarinë e institucionit. Por, nisur nga rasti i fundit me pasojë vdekjen e të paraburgosurit R.T në datë 01.04.2023 në ambientet e urgjencës të QSUT-së, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore të detajuar nga ana e mjekut dhe e psikologut, për njohjen e gjendjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e sëmundjeve, vdekjeve apo vetëvrasjeve, si dhe evidentimin e problemeve shëndetësore në një regjistër të veçantë, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara.

Masat disiplinore për të paraburgosurit, evidentoheshin në regjistrin e shkeljeve dhe masave disiplinore. Procedura e dhënies së masës disiplinore, ndiqej nga Komisioni i Disiplinës i ngritur në këtë institucion për këtë qëllim, sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. I paraburgosuri që kishte kryer shkelje të disiplinës, pasi njihej me vendimin e Komisionit të IEVP-së, kishte të drejtën e ankimit pranë komisionit të apelit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës⁴. Kjo praktikë ndiqej në mënyrë rigorozë nga drejtuesit e institucionit veçanërisht në lidhje me komunikimin e vendimit dhe të drejtën e ankimit. Grupi i inspektimit nuk pati ankesa nga të paraburgosurit përveçse më sipër.

Takimet me familjarët zhvilloheshin në ambientet e takimeve që ndodheshin në katin e parë të secilës godinë (A, B dhe C) në regjimin e brendshëm. Të paraburgosurit që ndodheshin në ambientin e regjimit të posaçëm (41 biss) kishin ambient me vehte takimi me familjarët. Numri i takimeve, zhvilloheshin sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, 4 herë në muaj (nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim me skype) për të paraburgosurit në regjimin e zakonshëm dhe 1 herë në muaj për të paraburgosurit në regjimin e sigurisë së posaçme (41 bis). Takimet e të paraburgosurve me familjarët, ishin të planifikuara dhe miratuara çdo ditë nga drejtori i institucionit. Në rastet kur të

⁴ Neni 17 i ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" dhe neni 89 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

paraburgosurit, kryesisht shtetasit e huaj, nuk kishin mundësi të kryenin takime fizike me familjarët për shkak të largësisë, drejtoria e institucionit lejonte komunikimet me skype më shumë se 1 herë, brenda numrit 4 të takimeve. Nga intervistat, grupi i inspektimit të MKPT-së nuk pati ankesa nga të paraburgosurit, në lidhje me respektimin e takimeve apo për komunikimet në telefon me familjarët e tyre.

Komunikimi me telefon me familjarët, kryej me kartë nga aparatet e telefonave që ishin të instaluar në korridoret e secilit prej sektorëve në regjimin e brendshëm dhe në ambientet e ajrimit. Ata ishin në gjendje pune dhe të paraburgosurit deklarorin se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Të paraburgosurit ngritën ankesa për çmimin e rritur të kartës telefonike, ndërkohë që koha e bisedës ishin zvogëluar. Gjithashtu, aparatet e telefonit nuk përballonin fluksin e nevojave për telefon për çdo sektor.

Të paraburgosurit ngritën si problematikë se, nuk mund të komunikonin me institucionin e Avokatit të Popullit, pa pagesë dhe në çdo kohë. Nga inspektimi u konstatua se, numrat e telefonit të Avokatit të Popullit **nuk** ishin të afishuar në vende të aksesueshme për të paraburgosurit. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve thuhet shprehimisht se: *“I burgosuri mund të komunikojë me Avokatin e Popullit në telefon, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në çdo kohë”*⁵. Sa më sipër, ky konstatim përbën shkelje të të drejtave të të paraburgosurve, në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimimit pranë Avokatit të Popullit.

Organika e të punësuarve në I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, ishte e miratuar për 20 të paraburgosur, por aktualisht institucioni kishte lidhur kontratat e punës me 17 të punësuar. Ata kryenin detyra si sanitar, nd/kuzhiner, mirëmbajtës, lavanderi dhe berber. Nga intervistat e zhvilluara, të punësuarit nuk kishin pretendime për kushtet e punës dhe kishin lidhur kontratat e punës në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.01.2021. Disa prej tyre, ngritën me shqetësim faktin se, ende nuk kishin kaluar pagesat për punën e kryer, pavarësisht lidhjes së kontratave. Nga interesimi që grupi i inspektimit bëri te drejtuesit e institucionit, u informua se, situata e prezantuar nuk është për mungesë të fondeve, por disa nga të punësuarit nuk kanë siguruar mjete identifikimi (kartë ID apo pasaportë), ndaj e kanë të pamundur të hapin numrat e llogarisë në bankë. Aktualisht institucioni kryente pagesa të punësuarve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm dhe numrin e llogarisë në një nga bankat e nivelit të dytë. Në momentin që i punësuarit do ta hapi numrin e llogarisë në bankë, do të bëhet e mundur edhe kalimi i pagesave mujore nga institucioni, që nga data e lidhjes së kontratave të punësimit me institucionin.

Grupi i inspektimit kërkoi informacion edhe në lidhje me masat e marra për respektimin e të drejtës së votës të të paraburgosurve. Sipas informacionit, nga 441 të paraburgosur vetëm 149 persona plotësonin kriteret ligjore për votim⁶. Në komunikimin e Komisionerit të MKPT-së me DPB, jemi informuar se të gjithë të paraburgosurit janë të pajisur me karta

⁵ Neni 17 i ligjit 81/2020 dhe neni 67 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

⁶ Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, neni 2/pika 1 dhe 4.

ID për zgjedhje. Por, për shkak të dinamikës të lëvizjeve të të paraburgosurve, me qëllim respektimin e kësaj të drejte, institucioni po merrte masa për plotësimin me karta identiteti për personat që nuk e dispononin mjetin e identifikimit. Në çdo rast, kjo kryhej sipas kërkesës të të paraburgosurve dhe marrjen e deklaratave për të gjithë ata që nuk kishin mundësi ekonomike për të blerë kuponin e kartës.

Ambientet e jashtme dhe të brendshme të I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, ishin të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë. Ato mbahen nën vëzhgim nga punonjësit e policisë në sallën operative përgjatë 24 orëve. Pamjet filmike të kamerave, ruhen në një server për një periudhë kohore deri në 30 ditë dhe administrohet nga punonjësi i IT-së të institucionit.

Grupi i MKPT-së, inspektoi edhe kushtet e ambienteve në godinën “C”, si dhe respektimin e të drejtave dhe trajtimin e personave të paraburgosur që ndodhen në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë të këtij institucioni, sipas përcaktimeve në nenin 17 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Në ambientet e regjimit të posaçëm, ndodheshin 2 të paraburgosur, referuar urdhërave të Ministrisë të Drejtësisë për secilin prej tyre. Në katin zero ndodhen ambientet e shërbimeve si mjedisi i takimit me familjarët (pesë poste takimi të ndara me xham dhe komunikimi kryhej përmes telefonit/citofonisë), një dhomë e takimit me avokatin/ prokurorin apo oficerin e policisë gjyqësore, një dhomë këshillimi, si dhe mjedisi i tualeteve dhe dusheve i ndarë në tre bokse.

Në katet e tjera (një kat i ndërtuar nëntokë), ndodhen dhomat e të paraburgosurve dhe ambienti i dusheve i cili është i përbashkët për çdo kat. Në secilin kat ndodhen 5(pesë) dhoma, të kompletuara me dy krevatë të fiksuar në dysheme, një tavolinë e vogël, një kalorifer për ngrohje, një tualet me një lavaman me rubinet dhe një pasqyrë alumini e fiksuar në mur me vida. Në dhoma ishin instaluar aparate TV, ku të paraburgosurit mund të ndiqnin kanale televizive të limituar dhe me orar të reduktuar, sipas programit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Kapaciteti fizik i kësaj godine është për të garantuar trajtimin dhe sigurinë e 20 të paraburgosurve, pavarësisht se numri i shtretërve është deri në 40 persona.

Dritaret e dhomave mbyllen me kanata hekuri me xham, të siguruar në pjesën e jashtme me skarë hekuri dhe me grrilë hekuri të fiksuar në mur. Të paraburgosurit, sikurse dhe vitet e kaluara, ngrinin si shqetësim mungesën e ajrimit dhe dritës natyrale në dhomat e banimit. Në këto kushte, ata kërkonin si zgjidhje lënie hapur të dyerve të brendshme të dhomave gjatë ditës, gjë e cila është e ndaluar me rregullat e miratuara për funksionimin e regjimit të posaçëm.

Nga intervistat me dy të paraburgosurit në regjimin e posaçëm rezultoi se, takimet fizike me familjarët e tyre kryheshin rregullisht 1(një) herë në muaj, po ashtu edhe bisedat telefonike 1(një) herë në muaj, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore, për këta persona.

Koha e ajrimit ishte i vetmi aktivitet që zhvillohej rregullisht me të paraburgosurit në këtë regjim. Ambienti i ajrimit ndodhej në sheshin përpara godinës “C” dhe përbëhej nga 4 bokse ajrimi të cilat ishin me gjatësi dhe gjerësi të mjaftueshme për të kryer lëvizje, ndërsa në pjesën e sipërme ai ishte i mbuluar me rrjetë, për arsye sigurie. Orari i ajrimit ishte përcaktuar në rregulloren e regjimit të posaçëm dhe kryhej 2 orë çdo ditë. Të paraburgosurit në këtë regjim, ngritën si të nevojë të domosdoshme krijimin e një palestre për ushtrime force në këtë ambient, si një mundësi alternative për aktivitetet sportiv që duhet tu sigurohet këtyre personave.

Dushet janë të përbashkëta për secilin kat, me nga 6 (gjashtë) bokse për larjen e trupit. Kokat e dusheve ndodheshin në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dyshemeja, të fiksuara në murin ndarës të bokseve.

Në korridorin e secilit kat, janë të instaluar nga dy aparate telefoni me kartë, për të komunikuar me familjarët e tyre, sipas procedurave të miratuara për këtë qëllim. Nga verifikimi që kreu grupi i inspektimit, edhe të paraburgosurit në regjimin e posaçëm nuk mund të komunikojnë me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit. Sikurse përmendëm edhe më lart, ky konstatim përbën shkelje të të drejtës së të burgosurve, përfshirë edhe personat që vuajnë dënimin në regjim të posaçëm, për të komunikuar në çdo kohë dhe pa pagesë me institucionin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. U evidentua se edhe në këtë sektor, nuk ishin të afishuar numrat e telefonit të Avokatit të Popullit.

Të paraburgosurit, ngritën disa problematika që kishin të bënin me nevojën e kontakteve të përditshme me mjekun e institucionit dhe specialistin e çështjeve shoqërore, mungesën e aktiviteteve kulturore, sportive dhe fetare, si dhe mungesën e larmisë të titujve të librave për lexim në bibliotekë, pasi ka vetëm libra me karakter fetar.

Avokati i Popullit mbështetur në standardet kombëtare e ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe dinjitetin njerëzor të këtyre personave, si dhe nga studimi i eksperiencave të vendeve të tjera ku është zbatuar regjimi i posaçëm (41 bis), ka rekomanduar⁷ lehtësimin e disa masave në këtë regjim, pasi këta këta të burgosur nuk duhet të privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, leximi i librave, veprimtari që i shërbejnë rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre.

Ndërsa Avokati i Popullit vlerëson përmirësimin e disa kushteve, sjell në vëmendje të autoriteteve përgjegjëse, se ka ende mundësi për të përmirësuar disa kushte infrastrukturore për të krijuar kushte të përshtatshme jetese brenda izolimit, për shkaqe sigurie.

Aktivitetet me karakter këshillues, qofshin këto edhe individuale në këtë regjim, janë edhe më të domosdoshme se në çdo regjim tjetër, me qëllim për të zbutur rreptësinë e kufizimeve të parashikuara në ligj. Avokati i Popullit në inspektimet e zhvilluara në ambientet e regjimit të posaçëm vitet e fundit, ka konstatuar dhe rekomanduar

⁷ Rekomandim nr.K4/A4-5 prot., datë 23.09.2020 drejtuar Ministrisë të Drejtësisë dhe DPB-së.

përmirësimin apo rregullimin e disa masave kufizuese si vendosjen e pajisjeve TV në çdo dhomë, përmirësimi i cilësisë të ushqimit etj. Këto masa vlerësohen nga ana jonë, si hapa pozitiv drejt përmirësimit të trajtimit dhe krijimit të kushteve normale për këta persona, pavarësisht veprës penale që ata akuzohen se kanë kryer, por konstatojmë se ende vijon të kenë shumë kufizime për këta persona.

Kushtet materiale

Kushtet materiale të IEVP-së, në funksion të të burgosurve për jetesë normale dhe aktivitete rehabilituese, përbëjnë një element shumë të rëndësishme në respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, të cilat duhet të garantohen në zbatim të akteve ligjore e nënligjore vendase, si dhe akteve ndërkombëtare.

Regjimi i brendshëm në IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, përbëhet nga 3(tre) godina për banim (godina A, B dhe C), si dhe disa ambiente shërbimi për të paraburgosurit. Nga inspektimi, kushtet infrastrukturore të godinave, paraqiten si më poshtë vijon:

Godina A është e ndërtuar që në vitin 1929 dhe pavarësisht disa rikonstruksioneve të pjesëshme në vite, godina është shumë e amortizuar dhe me lagështirë. Mjediset që u ofrohen të paraburgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes nuk respektojnë dinjitetin njerëzor, si dhe nuk plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, referuar kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit. Në dhoma u gjetën të akomoduar 2, 4 dhe 6 persona. Ndërkohë që, sipërfaqe dhe hapsira e dhomave të banimit në këtë godinë, janë me përmasa të vogla dhe nuk plotësojnë normën minimum të hapësirës për person (Rekomandim i përsëritur i Avokatit të Popullit dhe KPT-së⁸), që duhet të jetë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në dhomë sistemohen më shumë persona.

Në vijim të këtij rekomandimi edhe në ligjin 81/2020 përcaktohet shprehimisht se: *“Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”*.⁹

Si shihet më sipër, ky standard tashmë është i përfshirë në ligjin e brendshëm, në përmirësim të standardit edhe të KPT-së (CPT) dhe përbën një garanci të shtuar për të tërë të paraburgosurit dhe të dënuarit që akomodohen në IEVP, pavarësisht kushteve dhe mundësive konkrete që kanë këto institucione.

Pavarësisht kushteve infrastrukturore që ndodhet godina “A”, dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje dhe me orënditë e nevojshme si tavolinë, stola dhe komodina, por hapsirat e vogla të dhomave **nuk** lejonin orëndi për ruajtjen e sendeve

⁸ shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 17-19

⁹ Neni 33, pika 4 e ligjit 81/2020.

personale dhe ushqimeve të të paraburgosurve, duke i detyruar të paraburgosurit ti mbajnë sendet personale në qeska të vendosura në dysheme. Kjo situatë, cënon rëndë kushtet higjenike.

Niveli i ajrit dhe dritës natyrale në dhoma ishte në norma të lejueshme, ndërkohë që të gjitha ambientet në regjimin e brendshëm, kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik dhe nga gjeneratori, që shërbente si burim alternativ për furnizimin me energji elektrike në rast difekti të rrjetit elektrik.

Sa më sipër, drejtuesit e IEVP-së në bashkëpunim me DPB, duhet të rishikojnë në mënyrë të menjëhershme aktet e brendshme që përcaktojnë kapacitetin fizik të IEVP 313 “Jordan Misja” dhe veçanërisht në godinën “A”, me qëllim që personave që do akomodohen në dhomat e banimit, t’u garantohet e drejta për normat minimale të hapsirës dhe sipërfaqes për çdo të paraburgosur.

Në katin e parë të godinës A ndodhen dhe sektori i observimit, veçimit dhe ai i tranzitit. Nga pikpamja e sigurisë, rregullave dhe procedurave që ndiqeshin, këta sektorë funksiononin normalisht sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Në ditën e inspektimit në sektorin e tranzitit, në sektorin e observimit dhe në dhomat e veçimit ndodheshin 24 të paraburgosur, nga të cilët 14 në sektorin e tranzitit, 6 persona në sektorin e observimit, ndërsa në dhomat e veçimit 4 person me masë disiplinore. Në sektorin e tranzitit janë 11 dhoma me kapacitet për 24 persona.

Grupi i MKPT-së, në mënyrë të përsëritur konstatoi se, këto ambiente kishin mungesë të theksuar të kushteve materiale për fjetje, kushteve higjenike dhe atyre shëndetësore. Ambienti është me lagështi në dhomat e banimit, prezencë të brejtësve dhe insekteve, mungesë të materialeve higjeno-sanitare për pastrimin e dhomave dhe korridoreve, si dhe mungesë të ujit të ngrohtë dhe dusheve për larjen e trupit. Duhet të kemi parasysh se, në këto ambiente të paraburgosurit qëndrojnë disa ditë (5-7 ditë) deri në përfundim të seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe transferimin e tyre në IEVP ku ata vuajnë dënimin, përfundimin e afatit të ekzekutimit të masës disiplinore apo dhe të periudhës së përshtatjes me institucionin për hyrjet e reja (10-14 ditë). Ndaj është e patolerueshme që këto ambiente të jenë në kushte degraduese dhe jo dinjitoze për jetesë normale, kushte jo të mira higjeno-sanitare dhe shëndetësore, pavarësisht ditëve që të paraburgosurit qëndrojnë aty.

Institucioni i Avokatit të Popullit, prej disa vitesh ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcionin, lysterjen dhe dizifektimin e shpesh të këtyre ambienteve, por sikurse konstatohet dhe nga inspektimi periodik i këtij viti, situata paraqitet e njëjtë dhe e pandryshueshme. Drejtuesit e institucionit e justifikojnë gjendjen e ambienteve, me sjelljen keq të personave që qëndrojnë në këto dhoma, pasi i dëmtojnë dhe shkatërrojnë qëllimisht ato, ndërkohë që mundësia për investime me fonde nga ana e institucionit është shumë e vogël. Situata në këto sektorë është në varësi të dinamikës së prurjeve të reja, si dhe numrit të të paraburgosurve që paraqiten për seanca gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë, aktualisht e vetmja gjykatë pas hyrjes në fuqi të ligjit për

miratimin e hartës së re gjyqësore. Deri në realizimin e një zgjidhje definitive, numri i personave në ambientin e tranzitit do vijojë të rritet. Për këtë arsye duhet të merren masa të menjëhershme nga ana e institucionit.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, kërkohet një vëmendje më e shtuar për përmirësimin e kësaj situate në sektorin e observimit dhe të tranzitit në IEVP 313 “Jordan Misja”, jo vetëm nga administrata e këtij institucioni, por edhe nga DPB si organ epror dhe me mundësi financimi dhe logjistike më të shumta. Njëkohësisht, institucioni duhet të nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe disiplinore ndaj kujdo që lejon apo dëmton ambientin, materialet dhe orenditë që ndodhen në këto sektorë.

Godinat B dhe C (regjimi i posaçëm) janë ndërtuar vitet e fundit dhe kanë kushte dhe infrastrukturë më të mirë për jetesë. Në përgjithësi, infrastruktura e këtyre godinave plotëson nevojat e të paraburgosurve për jetesë normale dhe garanton elementët e sigurisë. Të paraburgosurit në këto godina ishin të kompletuara me krevat, dyshek, batanie, jastëk dhe çarçafë nga institucioni, por një pjesë e tyre paraqitën ankesa se materialet e fjetjes ishin të vjetëruara dhe të dëmtuara, sidomos dyshekët. Sipas informacionit të sektorit të logjistikës, zëvendësimi i dyshekëve të dëmtuar me dyshekë të rinj, ka norma dhe afate të përdorimit të tyre, të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Në këto kushte, të paraburgosurit deklarorin se një pjesë e materialeve të fjetjes, i siguronin nga familjarët e tyre.

Ngrohja e ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej me kaldajë qëndrore, por ajo paraqitej herë pas here me probleme për shkak të defekteve teknike, ndaj oraret për ngrohje të ambienteve gjatë ditës, ishin të kufizuara. Në këto kushte, nga ana e institucionit ishin marrë disa masa për të lejuar futjen e ngrohësave dhe ftohëseve elektrike në dhoma, sipas stinëve. Përdorimi i këtyre pajisjeve elektrike, krijonte për rrjedhojë ngarkesë në rrjet dhe defekte të shpeshta elektrike, kryesisht në godinën “A” ku sistemi elektrik ishte i amortizuar.

Ambientet e dusheve ishin të mirëmbajtura dhe në përgjithësi ishin me kushte të mira higjieno sanitare, sidomos në dy godinat e reja. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit sipas sektorëve, u paraqitën ankesa në lidhje me furnizimin me ujë të rrjedhshëm (me grafik 3 herë në ditë nga 1,5 orë) pasi furnizimi aktual nuk përballonte nevojat për higjienë personale dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta, si dhe sasia e ujit të ngrohtë nuk përballonte larjen e trupit me ujë të ngrohtë 2 (dy) herë në javë, për të paraburgosurit sipas sektorëve.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, rezultoi se, furnizimi me ujë të rrjedhëm i ambienteve në regjimin e brendshëm, kryhej rregullisht nga Ndërmarrja e UK Tiranë. Institucioni kishte vendosur 4 (katër) depozita me ujë me kapacitet 5 000 litra secila, me një total prej 20 000 litrash. Ndërsa, ngrohja e ujit realizohej me bolier dhe me panele diellore. Në ambientet e përbashkëta, kishte bazë materiale të shpërndarë sipas nevojave.

Në IEVP “Jordan Misja” kishte palestër, klasa dhe dhoma këshillimi sipas sektorëve. Palestra ishte e pajisur me mjete të vëna në dispozicion nga institucioni, si dhe vegla për ushtrimin e forcës të sjella nga vetë të paraburgosurit. Ushtrimi në palestër dhe orari i ajrimit, ishin aktivitetet kryesore që zhvillonin të paraburgosurit.

Ambientet e kultit ishin të bollshme, me ndriçim dhe të pajisur me orenditë e nevojshme. Kryerja e riteve fetare, kishte filluar të lejohej, pas një kufizimi të gjatë të tyre, për shkak të periudhës së pandemisë.

Institucioni ka në total 12 (dymbëdhjetë) ambiente ajrimi, nga të cilat 4 (katër) bokse ndodhen në tarracën e godinës ‘A’ dhe 8 (tetë) bokse në sheshin mes godinave. Këto ambiente ishin të pastra dhe të mirëmbajtura. Në këto ambiente ndodheshin gjithashtu edhe telefona me kartë ku të paraburgosurit i shfrytëzojnë për të kontaktuar me familjarët e tyre. Aparatet e telefonave ishin funksionale në të gjitha ambientet e ajrimit.

Kuzhina e institucionit ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, si dhe me kushte higjeno-sanitare të mira. Ambienti i kuzhinës ishte i ljer. Brenda hapësirës të kuzhinës ndodhet magazina për ruajtjen e ushqimeve. Gatimi i ushqimit kryhej në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit janë të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menuja ditore e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Stafi i kuzhinës përbëhej nga 6 guzhiner dhe 4 nd/guzhiner (të paraburgosur të punësuar), pa llogaritur të punësuarit që shpërndanin ushqimin sipas sektorëve. Në momentin e inspektimit, po përgatitej shpërndarja e vaktit të drekës dhe u evidentua se, produktet ushqimore dhe të mishit, ishin sipas menisë ditore. Të paraburgosurit e sëmurë me diabet kishin menu gatimi më vehte.

Kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Në përgjithësi, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit dhe të shpërndarjes sipas sektorëve, rezultuan në gjendje të mirë. Pavarësisht kësaj situate, disa nga të paraburgosurit ngritën ankesa grupit të inspektimit për cilësinë dhe mungesën e larmisë së ushqimit, ndaj në këto kushte ata detyroheshin të merrnin ushqime nga familjarët e tyre.

Në IEVP “Jordan Misja”, funksiononte njësi e re tregtare, nëpërmjet blerjeve online, ku tregtohen produkte të ndryshme ushqimore, si dhe për nevoja personale për të paraburgosurit. Nga drejtuesit e institucionit, u informuam se njësitë tregtare po funksionon normalisht, sipas projektit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Avokati i Popullit vlerëson se, kjo zgjidhje ka krijuar mundësinë për larmishmëri më të madhe të produkteve dhe ulje të abuzimit me çmimet e produkteve. Gjithashtu, ka ndikuar edhe për punësim të të dënuarve apo të paraburgosurve.

Nga inspektimi u evidentua se, lavanderia e institucionit që ndodhej në hyrje të godinës “A” funksiononte normalisht dhe ishte i punësuar një i paraburgosur. Ajo ishte e kompletuar me lavatriçe për larjen e rrobave dhe lavatriçe për tharjen e tyre. Nga

inspektimi rezultoi se, lavatriçet ishin në gjendje pune, por një pjesë e të paraburgosurve deklaroi se rrobat personale i dërgonin tek familjarët e tyre.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi i brendshëm në IEVP 313 “Jordan Misja”, organizohej mbi bazën e orarit ditor të miratuar nga drejtori i institucionit, i cili ishte i afishuar në vende të aksesueshme nga të paraburgosurit në klasa dhe në koridoret që lidhin dhomat e banimit me bokset e ajrimit. Aktivitetet zhvilloheshin sipas programit të miratuar për çdo sektorë, pavarësisht nga siguria që ata kishin. Nga veprimtaritë ditore, bënëin përjashtim të paraburgosurit që ndodheshin në regjimin e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që kishin masa disiplinore.

Spektori i çështjeve shoqërore në bashkëpunim me sektorin e policisë, kryenin veprimtari të ndryshme me të paraburgosurit sipas programit të miratuar, kryesisht trajtime dhe këshillime individuale apo në grupe me të paraburgosurit, sipas moshave dhe kërkesave të tyre. Aktivitetet me karakter kulturor, edukues dhe sportiv, ishin të reduktuara apo zhvilloheshin vetëm në rastet e festave kombëtare dhe fetare. Gjatë kohës tjetër të ditës, të paraburgosurit ndiqnin programet televizive në dhoma, si dhe kalonin në bokset e ajrimit dhe me lojëra tavoline (si lojëra me letra dhe domino).

Orari i ajrimit për këtë periudhë ishte 2 (dy) orë në ditë, por ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës, sikurse është e përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve¹⁰, por në çdo rast, kohëzgjatja maksimale e ajrimit përcaktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në varësi të nevojave të sigurisë, veprimtarive të përbashkëta, punësimit ose vetëpunësimit, nevojave edukative dhe shkaqeve të tjera sipas nevojave të institucionit. Ambientet e kultit frekuentohen nga praktikuesit e fesë muslimane dhe besimtarët protestantë, me qëllim që ata të praktikojnë ritet e tyre fetare, sidomos gjatë festave fetare.

Të paraburgosurit e intervistuar nga grupi i MKPT-së, paraqitën ankesa në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve, pasi ato nuk ishin të larmishme. Ata kërkonin të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, me qëllim formimin dhe rritjen e kapaciteteve për rehabilitimin e tyre. Një nga qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i të burgosurve, në momentin kur ata do të lënë burgun. Lidhur me qëllimin e aktiviteteve në burgje, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹¹.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato formalisht ishin të plotësuara me shënime periodike mbi takimet dhe

¹⁰ Neni 30 dhe 63 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve

¹¹ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARD_SETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf

aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet përkatëse ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike.

Në dy godinat A dhe B ndodheshin 8(tetë) ambiente të përbashkëta klasa edukimi dhe biblioteka. Këto ambiente ndodheshin në secilin nga sektorët e institucionit dhe ishin të pajisur me libra që vihen në dispozicion të të paraburgosurve për lexim sipas kërkesave të tyre. Të paraburgosurit e regjistruar në bibliotekë, ishin hapur kartela personale dhe nëpërmjet saj punonjësi i sektorit të edukimit bënte shpërndarjen e librave sipas kërkesave të të paraburgosurve. Numri i të regjistruarve në biblioteka ishte shumë i kufizuar, pasi interesi i të paraburgosurve ishte për të lexuar libra që ti tërheqin artistikisht, ndërkohë që shumica e titujve të librave ishin libra me karakter fetar.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, në kushtet kur mungojnë ambientet dhe aktivitetet e larmishme, ngjallja e interesit të të burgosurve për leximin e librave artistik nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore, është jo vetëm detyrë, por një mundësi shumë e mirë për kalimin e kohës së lirë nga ana e tyre, si dhe një alternativë për të ulur nivelin e stresit dhe depresionit, që janë prezente në institucionet e sistemit penitenciar. Kjo problematikë në I EVP 313, është evidentuar edhe në raportin e KPT-së (CPT) në vizitën inspektuese që ka zhvilluar në Shqipëri në vitin 2018¹², por ende nuk ka gjetur zbatim.

Shërbimi Shëndetësor

Një nga qëllimet e vizitës inspektuese në I EVP “Jordan Misja” Tiranë, ishte cilësia e ofrimit të shërbimit shëndetësor për të paraburgosurit në këtë institucion. Personeli i shërbimit shëndetësor në institucion, sipas organikës përbëhej nga 12 (dymbëdhjetë) punonjës staf, nga të cilët 2 mjek, 1 farmacist, 1 stomatolog dhe 8 infermierë. Mjeku i përgjithshëm ishte i punësuar me kohë të plotë, ndërsa 1 mjek ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesëshme 4 orë në ditë dhe në çdo rast urgjence (sipas kontratës të lidhur me institucionin). Pjesa tjetër e stafit mjekësor ishte e punësuar me kohë të plotë.

Nga statistikat e stafit të sektorit shëndetësor të institucionit mbi sëmundshmërinë, në ditën e inspektimit ishin 205 të paraburgosur të diagnostikuar me sëmundje të ndryshme, kryesisht kronikë 78 të sëmurë, 30 të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, 17 persona që marrin trajtim me metadon, 10 persona të sëmurë me diabet, etj.

Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve, funksiononte sipas kontratës tre paleshe midis institucionit, FSDKSH dhe depos farmaceutike. Institucioni për shkak të dinamikës të lëvizjeve të të paraburgosurve dhe vonesave në plotësimin e dokumentacionit, kjo skemë nuk funksiononte rregullisht, duke krijuar problematika dhe vështirësi në pajisjen me libra shëndetësore dhe sigurimin e ilaçeve për të sëmurët kronikë.

Një problematikë e evidentuar nga ankesat e të sëmurëve kronikë në I EVP 313, kishte të bënte dhe me emërtimin e ilaçeve në listën e ribursimeve. Të paraburgosurit e sëmurë para

¹² “KPT rekomandon që të ndërmerren masa për zhvillimin e aktivitete të organizuara jashtë-qelisë për të paraburgosurit në bllloqet e reja të akomodimit në I EVP Nr. 313”.

se të hynin në institucionin e vuajtjes së dënimit, kanë përdorur ilaçe me emërtime të cilat nuk janë në listën e ribursimit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, për të njëjtën sëmundje. Në këto kushte, kjo kategori nuk pranonin ilaçet e siguruara nga lista e ribursimit, por pranonin të kuroheshin me ilaçet e siguruara nga familjarët e tyre.

Veç skemës trepalëshe që institucioni kishte lidhur me FSDKSH dhe depon farmaceutike, sigurimi me ilaçe në institucion, kryhej edhe nga dy burime të tjera, nëpërmjet furnizimit nga fondi i ilaçeve të siguruara nga DPB dhe blerjeve nga fondi i vetë institucionit, për të sëmurët me probleme të ndryshme shëndetësore.

Ambientet e shërbimit shëndetësor ndodhen në katin e parë të godinës “A” dhe godinës “B” të institucionit. Në këto ambiente ndodhej dhoma e mjekut për vizitat mjekësore, dhoma e stomatologut, si dhe dhoma e urgjencës ku qëndronte stafi i infermierëve. Farmacia e institucionit, ndodhej në godinën e administratës në regjimin e jashtëm, ku kryhej administrimi dhe shpërndarja e ilaçeve për të sëmurët sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Dhoma për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, ishte e kompletuar me pajisjet mjekësore dhe orenditë e nevojshme si shtrati, rafti për mbajtjen e dokumentacionit, tavolinë pune dhe karrike për qëndrimin ulur. Ambientet ishin të lyera dhe me kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige pune, sterilizues dhe njësi dentare funksiononale. Stomatologu kryente mjekime në çdo kohë, sipas kërkesave të të parburgosurve. Institucioni ishte i pajisur me ambulancë të re për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Stafi i infermierëve kryente shërbim me 3 turne përgjatë 24 orëve. Ata ndiqnin dinamikën e të sëmurëve kronikë dhe rastet e urgjencave, por në çdo kohë në kontakt me mjekun e institucionit. Shpërndarja e medikamenteve kryhej në bazë të rekomandimit të mjekut për çdo të sëmurë kronikë, duke qenë prezent në marrjen e terapisë nga i sëmuri dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike ruheshin në një dollap në dhomën e mjekut dhe ishin të plotësuara sipas rubrikave, për çdo të parburgosur pavarësisht nga gjendja shëndetësore. Gjithashtu nga këqyrja e regjistrit të vizitave të mjekut, regjistrit për evidentimin e rasteve të dhunës, si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, rezultoi se, ishin të protokolluar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Vizita inspektuese e MKPT-së në këtë institucion, u zhvillua disa ditë më parë se të ndodhte ngjarja e rëndë me pasojë vdekjen e shtetasit R. T në datë 01.04.2023 në ambientin e urgjencës të spitalit QSUT. Shtetasi kishte shfaqur probleme të rënda shëndetësore dhe ishte dërguar me urgjencë nga IEVP për në QSUT, ku kishte gjetur edhe vdekjen. Nga autopsia e bërë ka rezultuar se, vdekja e të parburgosurit ka ndodhur si pasojë e një arresti kardiak. Pavarësisht informacioneve të marra nga drejtuesit dhe

punonjësit e policisë të IEVP 313 “Jordan Misja”, si dhe nga autopsia e spitalit, institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar menjëherë procedurat për hetimin administrativ të kësaj ngjarje të rëndë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Nga informacionet paraprake të grumbulluara nga grupi i punës i ngritur për hetimin e këtij rasti, mësohet se viktima ishte 37 vjeç, me status i paraburgosur dhe vënë nën akuzën e kryerjes së veprës penale “Vjedhje” dhe “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” nga punonjësit e policisë të Komisarariatit nr.3 Tiranë. Arrestimi ishte kryer në flagrancë më datë 27.03.2023 nga punonjësit e policisë të këtij komisarati dhe në përfundim të veprimeve procedurale, ishte dërguar menjëherë në dhomat e sigurisë (“Bllokun e sigurisë”) të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Pas vleftësimit të masës së sigurisë, Gjykata e Shkallës së parë Tiranë me datë 31.03.2023 ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg” për këtë shtetas dhe më tej ai ishte transferuar menjëherë për në ambientet e IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë.

Duke qënë se ende jemi në fillimet e hetimit të këtij rasti dhe në pritje të përgjigjeve të kërkesave për informacione, dërguar menjëherë institucioneve përgjegjëse të ngarkuar me ligj për zbardhjen e kësaj ngjarje, **sjellim në vëmendjen e autoriteteve të organeve të policisë por edhe autoriteteve të burgjeve**, të ketë dokumentim më të mirë të personave që paraqiten me probleme shëndetësore dhe të garantojnë cilësi më të mirë të shërbimit shëndetësor, në mjediset e këtyre institucioneve.

Gjithashtu, institucionet e privimit të lirisë duhet të tregojnë më shumë përgjegjshmëri dhe të jenë më tepër bashkëpunues në respektimin e të drejtave të shtetasve që qëndrojnë në këto ambiente, për të garantuar në rradhë të pare sigurinë e jetës dhe të shëndetit të këtyre shtetasve, që raste të tilla mos përsëriten më në ambientet e burgjeve apo dhe të paraburgimeve.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për zbatimin me rigorozitet të procedurave dhe protokollit shëndetësor që ndiqet nga Komisioni i pritjes të institucionit, për

kqyrjen fizike, intervistimin dhe ekzaminimin e plotë shëndetësor të të paraburgosurve, që hyjnë si prurje të reja në institucion, me qëllim parandalimin e rasteve kryesisht atyre me pasojë vdekjen e personit.

2. Të merren masa të menjëhershme, për miratimin e rregullores së brendshme të IEVP-së 313 “Jordan Misja”, Tiranë, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Vendim nr. 209, datë 6.4.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.
3. Të merren masa të menjëhershme, për rishikimin dhe saktësimin e kapacitetit fizik të institucionit, duke parashikuar kapacitetin për çdo sektorë, nisur nga kushtet në të cilat ndodhen godinat e banimit, si dhe kriteri i sipërfaqes dhe i kubaturës të lejuar për person, të garantuara me aktet ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, për këtë qëllim.
4. Të merren masa të menjëhershme, për rregullimin, mirëmbajtjen, eliminimin e lagështirës, sigurimin e ujit të rrjedhshëm, dizifektimit dhe pastërtinë higjieno-sanitare të ambientit ku ndodhen dhomat e observimit dhe të veçimit. Të nxirren përgjegjësitë administrative dhe disiplinore ndaj stafit dhe të paraburgosurve që janë shkaktarë të kësaj situate të përsëritur ndër vite.
5. Të merren masa të menjëhershme nga DPB dhe IEVP, për saktësimin e kushteve në sektorin e tranzitit, shtimin e kapaciteteve, kompletimin e dhomave me orenditë e nevojshme, si dhe shkurtimin e kohës të qëndrimit të të paraburgosurve që vijnë nga IEVP-të e tjera.
6. Të merren masat e nevojshme, për rikonstruksionin e tarracës dhe riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik në godinën “A” të institucionit, me qëllim eliminimin e lagështirës në ambientet e banimit, si dhe në sektorin e tranzitit dhe të observimit.
7. Të merren masa të menjëhershme, për lyerjen, higjenizimin dhe dizifektimin e ambienteve të banimit, dhomave të tranzitit dhe të observimit në godinën A, për eliminimin e insekteve dhe brejtësve, pasi dëmtojnë rëndë shëndetin e të paraburgosurve që akomodohen në këto ambiente.
8. Të merren masa të menjëhershme, për afishimin në vende të aksesueshme për të paraburgosurit, të numrave për komunikimin me institucionin e Avokatit të Popullit, dhe të sigurohet ky komunikim në çdo kohë dhe pa pagesë.
9. Të merren masa të menjëhershme, për organizimin e aktiviteteve të larmishmëve kulturore, edukative dhe sportive, si dhe aktiviteteve fetare me të paraburgosurit, gjatë gjithë vitit jo vetëm në rastet e festave kombëtare dhe fetare, me qëllim rritjen e aftësive të formimit dhe të kapaciteteve rehabilituese të tyre.
10. Të merren masa të menjëhershme për kompletimin e bibliotekave dhe dhomave të këshillimit në sektorë, me tituj të librave të rinj, me qëllim rritjen e interesit të të paraburgosurve për leximin e librave.
11. Të merren masat e nevojshme organizative, për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e policisë, sipas strukturës organike të institucionit.

12. Të merren masat e nevojshme, brenda kuadrit ligjor, me qëllim respektimin e të drejtave dhe trajtimin dinjitoz të të paraburgosurve që ndodhen në regjimin e posaçëm (41 bis).
13. Të merren masat e nevojshme, për sigurimin e ujit të ngrohtë në ambientet e dusheve, që shërben për larjen e trupit të paraburgosurve dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta.
14. Të merren masat e nevojshme, për pajisjen me karta ID të paraburgosurit e punësuar, hapjen e numrave të llogarive në bakat e nivelit të dytë, si dhe kryerjen e pagesave mujore, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2022.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI